



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:110672
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05756618

Ac.nr.1803/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike sipas propozimit të propozuesve S.S, R.S dhe H.S m.v S nga Gj....., të cilët me autorizim i përfaqëson A.S, avokat nga Gjilani, ndaj kundërpropozueses Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.M, jurist nga Gjilani, për kompensimin e pasurisë së paluajtshme të eksproprijuar, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, N.nr.294/2017, i datës 02.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHEN të themelta ankesa e propozuesve S.S, R.S dhe H.S. m.v. S nga Gj..... dhe ankesa e kundërpropozueses Komuna e Gjilanit, ANULOHEM Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, N.nr.294/2017, të datës 02.07.2019 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, N.nr.294/2017, të datës 02.07.2019, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET PJESËRISHT si i bazuar, propozimi i S. e R. S. dhe H.S m.v. S., nga Gj....., ndaj kundërpropozueses, Komuna e Gjilanit, për kompensimin e pasurisë së paluajtshme të eksproprijuar dhe CAKTOHET kompensimi për eksproprijimin e ngas.kad.nr.P....., ZK Gj....., në v.q „K....., si tokë ndërtimore, për metër katrore vlersohet*

në lartësi prej 250,00 €, për sipërfaqen prej 560 m², të vlersuar dhe llogaritur në lartësi prej gjithësejt 140.000,00 €, e regjistruar në emër të të ndj. M.S, ish nga Gj....., sipas fl.pos. 2989 KK Gj....., pas eksproprijimit, e regjistruar si P.SH. në emër të Kuvendi i Komunës, në Gjiilan, sipas Çertifikatës nga lënda nr....., e lëshuar më dt.28.06.2019, nga DGJKP, K. e Gj.....

II. DETYROHET Kundërpropozuesja Komuna e Gjiilanit, Shfrytëzuesja për eksproprijim, që propozuesve, S. e R.S dhe H.S m.v. S., nga Gj....., /trashëgimtarët e të ndj. M.S, t ia kompensojn pasurinë e paluajtëshme të eksproprijuar përkatësisht ngas.kad.nr....., në sipërfaqe prej 560 m², të llogaritura në lartësi prej gjithësejt 140.000,00 €, me kamatën ligjore që do ti llogaritet, sa paguajnë qytetarët pa destinime të veçanta në Bankat afariste të Republikës së Kososvës, nga dt.27.11.2013, e ushtrimit të propozimit e deri në pagesën definitive, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, me vërejtje të përmbartimit të detyruar.

III. REFUZHET PJESËRISHT si e pa bazuar, kërkesa e propozuesve, S., R. S. dhe H.S-S., nga Gj.....për kompensimin e pasurisë së paluajtëshme, të eksproprijuar, të kërkuar sipas precizimit të kërkesës në lartësi prej 450 € për kompensimin për 1.m2, për sipërfaqen prej 560 m² e llogaritur 252,000,00 €. IV. REFUZHET si e pa bazuar, kërkesa e propozuesve, S. e R. S. dhe H.S-S., nga Gj.....për kompensimin e pasurisë së paluajtëshme, përkatësisht shtëpisë, pusit për ujin e pijshëm, WC fushore dhe fidaneve të pemëve, e kërkuar në shumën prej 34.898,00 €, për shkak se kërkesa e tillë konsiderohet si çështje e gjykuar. V. DETYROHET kundërpropozuesja, Komuna e Gjiilanit, t ia kompensojnë propozuesve shpenzimet e procedurës jokontestimore, si vijon: për hartimin e propozimit shumën prej 78 €, për pagesat e taksës gjyqësore shumën prej 500 €, për eksperin e bujqësisë shumën prej 150 €, për ekspertin e ndërtimtarisë shumën prej 150 €, për ekspertin financiar shumën prej 150 €, për ekspertin e gjeodezisë shumën prej 100 €, për pes seanca të plota të përfaqësimit shumën prej 676 €, të gjitha të llogaritura në lartësi prej gjithësejt 1,804.00 €, këtë në afat prej 15. ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, me vërejtje të përmbartimit të detyruar”.

Kundër këtij aktvendimi, propozuesit, përmes të autorizuarit të tyre, në afatin ligjor kanë parashtruar ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale duke nënkuptuar edhe shkeljen e dispozitave ligjore lidhur me shpenzimet e procedurës, me propozim që të aprovohet ankesa e propozuesve dhe të ndryshohet aktvendimi i shkallës së parë, ashtu që në emër të kompensimit për pronën e paluajtshme në sipërfaqe prej 560 m² të caktohet kompensimi në shumë prej 252.000 Euro, me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 15.642 Euro, plus shpenzimet për ushtrimin e ankesës në shumë prej 1040 Euro konform numrit tarifor. 9 (mjetet juridike në çështjet civile) të Tarifës së OAK-së.

Kundër këtij aktvendimi, kundërpropozuesja, përmes të autorizuarit të saj, në afatin ligjor ka parashtruar ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kundërpropozueses, që të prishet dhe ndryshohet si i pabazuar në Legjislacionin e Republikës së Kosovës, aktvendimi i shkallës së parë dhe atë në pikën I, II dhe V të dispozitivit dhe të refuzohet propozimi sa i përket këtyre pikave si të pabazuara në ligj, të vërtetohet aktvendimi i ankimuar në pikën III dhe IV si

i bazuar në ligj apo të prishet aktvendimi i aktvendimi i ankimuar sa i përket pikave I, II dhe V dhe ta kthejë rastin në rigjykim/rivendosje sa i përket vetëm këtyre pikave dhe poashtu që të kthehet në rigjykim te një gjyqtar tjetër.

Propozuesit kanë parashtruar përgjigje ndaj ankesës së palës kundërpropozuese, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim gjykatës së shkallës së dytë, që ankesa e kundërpropozueses ndaj aktvendimit të atakuar të refuzohet si e pabazuar.

Kundërpropozuesja ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së palës propozuese, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim gjykatës së shkallës së dytë, që ankesa e propozueses të refuzohet e pabazuar dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, e në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në pajtim me nenin 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK), ka gjetur se:

- Ankesat e palëve ndërgjyqëse janë të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesit, përmes të autorizuarit të tyre, në gjykatën e shkallës së parë me datën 27.11.2003, kanë paraqitur padi për kompensimin e paluajtshmërisë, të ngastrës kadastrale nr....., të eksproprijuar për nevojat e BVI-së për banim dhe punë komunale, që gjendet në vendin e quajtur “K.....”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0,05,60 ha, me kulturë shtëpi dhe oborr, e cila evidentohet në fletën poseduese nr....., Komuna Kadastrale Gj....., e cila paluajtshmëri në momentin e eksproprijimit ka qenë e evidentuar në emër të paraardhësit të paditësve, të ndjerit M.A.S, i cili nuk është kompensuar për paluajtshmërinë e eksproprijuar, andaj kanë kërkuar që pasi të caktohet vlera reale e pronës së eksproprijuar, të detyrohet kundërpropozuesja në kompensimin e shumave, me kamatë dhe shpenzimet e procedurës, e më detajisht sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.617/2003, të dt. 06.01.2004, e ka ndërprerë procedurën kontestimore sipas padisë dhe lënda është dërguar në procedurë jokontestimore.

Gjykata e shkallës së parë në procedurë jokontestimore e ka ndërprerë procedurën jokontestimore me aktvendimin N.nr.40/04, të dt. 09.01.2004, në afat prej 180 ditësh konform nenit 67.1 dhe 68 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Fillimisht, gjykata e shkallës së parë me aktvendimin N.nr. 40/2004, të datës 03.02.2012, e ka caktuar kompensimin për pasurinë e eksproprijuar propozuesve në vlerë prej 163.688.16 Euro, kundër të cilit aktvendim ankesë ka ushtruar kundërpropozuesja dhe Gjykata e Qarkut në Gjiilan me aktvendimin AC.nr. 97/2012 të dt. 18.07.2012, e ka aprovuar ankesën e kundërpropozueses dhe e ka prishur aktvendimin e shkallës së parë duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë me aktvendimin N.nr. 83/2012, të dt. 06.04.2016, e ka aprovuar pjesërisht propozimin e propozuesve duke ia caktuar kompensimin për pronën e eksproprijuar për 560 m2 nga 250 euro/m2, në shumën e përgjithshme prej 140.000 euro, ndërsa ia ka refuzuar kompensimin e shtëpisë, pusit, ujit të pijshëm, WC dhe të pemëve të ndryshme në shumë prej 34.899 euro, si çështje e gjykuar, i cili është prishur sipas ankesës nga Gjykata e Apelit me aktvendimin CA.nr. 2275/2016, të dt. 13.11.2017, për shkak se ekspertiza e vlerësimit të paluajtshmërisë është e mangët, për arsye se gjatë vlerësimit të paluajtshmërisë së eksproprijuar të propozuesve nuk është siguruar ndonjë kontratë e shitblerjes, për ngastrat fqinje, por ekspertiza është bazuar vetëm në deklarata të banorëve, e që në bazë të tyre nuk mund të vlerësohet paluajtshmëria.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të lëndës, duke i marrë për bazë sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë, ka nxjerrë dhe administruar provat relevante dhe pas administrimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim N.nr.294/2017 të datës 02.07.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht propozimin e propozuesit, e duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë, me provat e administruara ka ardhur në përfundim se pasuria e paluajtshme, ngastra kadastrale nr....., në sipërfaqe prej 0.05.60 ha, me kulturë shtëpi dhe oborr, me objekte tjera ndihmëse, më parë e regjistruar në emër të të ndjerit M.S, nga viti 1980, në bazë të nenit 2, 2a të Ligjit për Eksproprijimin, me ndryshime nenit 13, se në bazë të nenit 20, pasuria ishte eksproprijuar pa kompensim-pagesë, nga e paditura, sipas nenit 28, 29, 30 lidhur me nenin 15 të këtij ligji, kompensimi për pasurinë e eksproprijuar është llogaritur nga ekspertët përkatës, e që e njëjta ngastër e bashkangjitur me pasuritë tjera, ishte formuar ngastra P-....., me një sipërfaqe të krijuar prej 0.24.67 ha, e regjistruar si P.Sh. Kuvendi i Komunës G..... Gjykata përkundër faktit që iu është drejtuar Arkivit të Kosovës për të siguruar ndonjë provë për të vërtetuar faktin nëse propozuesit janë kompensuar për pasurinë e eksproprijuar, nuk është siguruar ndonjë provë në këtë drejtim. Gjykata sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, ka kërkuar plotësimin e ekspertizës për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme, ku eksperti ka siguruar provë-kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë fqinje dhe në bazë të kontratës është caktuar çmimi kompenzues për 1 m2 shuma prej 450 euro, e që për sipërfaqen e tërësishme prej 560 m2 është caktuar çmimi prej 450.000 euro. Gjykata e ka vlerësuar këtë caktim të çmimit tejet të lartë dhe të papërbalueshëm për kompensim nga Komuna e Gjilanit dhe për këtë arsye pjesërisht e ka refuzuar kërkesën e propozuesve për tepricën e kërkuar sipas rivlerësimit nga eksperti i bujqësisë, ndërsa e ka marrë për bazë rivlerësimin e ekspertit të ndërtimtarisë. Nga prova-njoftimi nga Arkiva e Kosovës, të njëjtit e kanë njoftuar gjykatën se nuk është gjetur aktvendimi për kompensim të ngastrës 2464-2 dhe nga kjo gjykata ka vërtetuar faktin se paraardhësi i propozuesve me të vërtetë nuk është kompensuar dhe se ishte neglizhuar dhe prolonguar procedura për kompensimin e propozuesve për pasurinë e eksproprijuar, nga kundërpropozuesja. Gjykata duke u bazuar në aktvendimin N.nr. 391/1980, i dt. 23.10.1980, të Gjykatës Komunale në Gj....., konstatoi se propozuesi nuk kishte ushtruar ankesë ndaj vendimit me të cilin pjesërisht është aprovuar kërkesa për kompensimin e pasurisë së paluajtshme, ngastrës, në sipërfaqe 0.05.60 ha, ndërsa ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e shtëpisë së ndërtuar pa leje, WC fushore, murit rrethues dhe fidaneve

shumëvjeçare dhe pasi që propozuesi nuk ka ushtruar ankesë, më çka konsiderohet se në heshtje pjesërisht e ka pranuar një kompensim për oborrin e eksproprijuar, ndërsa kundërpropozuesja ka mbetur pranë detyrimit që propozuesve t'iu kompensojë pasurinë e paluajtshme ngastrën, sa e ka vlerësuar eksperti i ndërtimtarisë.

Andaj gjykata ia ka caktuar kompensimin në shumën prej 140.000 euro, ndërsa e ka refuzuar propozimin për kompensimin për shtëpinë e ndërtuar pa leje. Gjykata poashtu theksoi se eksperti i ndërtimtarisë përkundër faktit që e ka vlerësuar paluajtshmërinë, 450 euro për m², por që propozuesit në seancën kryesore dhe përfaqësuesi i tyre, nuk e kanë precizuar kërkesëpadinë për rritjen e vlerës së kompensimit, andaj gjykata e ka aprovuar pjesërisht, ndërsa tepricën e kërkesës e ka refuzuar. Sa i përket kompensimit të pasurisë së paluajtshme: shtëpisë, WC fushore, 23 fidane shumëvjeçare, murin rrethues dhe bunarin për ujë të pijshëm, nga gjykata kompetente është konsideruar se propozuesi e ka tërhequr padinë apo është refuzuar kërkesa për kompensim të tillë, ndërsa propozuesi nuk ka ushtruar ankesë apo ndonjë procedurë sipas udhëzimeve të gjykatës dhe për këtë gjykata pjesërisht e ka refuzuar kërkesën e propozuesve për kompensim.

Lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata është mbështetur në dispozitat e nenit 2, 2a, 13, 20, 28, 29, 30, lidhur me nenin 15 të Ligjit për eksproprijim me ndryshime, nenin 14.par. 3, 17 par. 1 të LPJ-së dhe nenin 142 të LPK-së, ndërsa për shpenzime të procedurës ka vendosur në pajtim me nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e me këtë është zbatuar gabimisht e drejta materiale dhe për këto arsye aktvendimi i atakuar është dashur të priset, pasi që nuk kishte kushte që i njëjti të ndryshohet.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe pas ekzaminimit të aktvendimit të ankimuar, gjeti se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n). Aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e aktvendimit, ku gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare, ku në mes fakteve vendimtare eksitojnë kundërthënie midis asaj që thuhet në arsye të aktgjykimit dhe asaj që ekziston në përmbajtje të dokumentit, e kjo e bën që aktgjykimi të jetë i mangët.

Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të shkallës së parë është i paqartë, i pakuptimtë dhe i papërmbarueshëm për faktin se në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht propozimi i propozuesve dhe caktohet kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar në shumë prej 140.000 euro, ndërsa në pikën III të dispozitivit e refuzon pjesërisht propozimin e propozuesve për kompensimin e tokës së eksproprijuar në shumë prej 252.000 euro, “*të kërkuar sipas precizimit të kërkesës*”, ndërsa në arsyetim të aktvendimit në faqen 6 në

paragrafin e fundit kontaton se *“sipas rivlerësimit nga eksperti i ndërtimtarisë, pasuria e paluajtshme, përkatësisht parcela nr....., për m² është caktuar vlera në lartësi prej 450 euro për m², ndërsa shprehimisht propozuesit nuk janë deklaruar dhe përfaqësuesi i tyre në seancën kryesore nuk e ka precizuar kërkesën për rritjen e vlerës së kompensimit dhe për këtë gjykata konsideron se pjesërisht është aprovuar kërkesa e propozuesve, ndërsa për tepricën e kërkesës së propozuesve në raport të konstatuar nga eksperti i bujqësisë, gjykata e ka refuzuar si të pabazuar”,* ku për gjykatën ankimore është e paqartë tani a e ka precizuar/ndryshuar propozuesi kërkesën e tij, duke e rritur vlerën e kompensimit apo jo. Poashtu këto pika të dispozitivit janë në kundërshtim njëra me tjetrën për faktin se nëse gjykata ia aprovon pjesërisht kërkesën propozuesve, është dashur që pjesërisht pjesën tjetër të mbetur të kërkesës t'ia refuzojë, e jo tërë shumën e kërkuar, nëse gjen se e ka precizuar/ndryshuar, andaj këto dy pika të dispozitivit të aktvendimit janë të paqëndrueshme. Gjykata e Apelit gjeti se as kamata nuk është llogaritur në mënyrë të drejtë sipas Ligjit për Eksproprijimin e Pronës së Paluajtshme, si dhe rrjedhja e kamatës e cekur nga gjykata nga data e ushtrimit të propozimit datë 27.11.2013, ndërsa me shikim në shkresat e lëndës, kjo gjykatë gjeti se propozimi është paraqitur me dt. 27.11.2003, d.m.th, 10 vite më parë, andaj edhe pika II e dispozitivit të aktvendimit të ankimuar është e pasaktë dhe e papërmbarueshme. Poashtu edhe pika IV dhe V të dispozitivit janë të pasakta dhe kontradiktore, për faktin se gjykata ia refuzon kërkesën propozuesve për kompensimin e pasurisë së paluajtshme: shtëpisë, pusit për ujë të pijshëm, WC fushore dhe fidaneve të pemëve në shumë prej 34.898 euro, për shkak se kërkesa e tillë konsiderohet çështje e gjykuar. Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, nëse ka vlerësuar se është çështje e gjykuar sipas aktvendimit të N.nr.391/80, të dt. 23.10.1980, me të cilin në pikën I të dispozitivit është aprovuar propozimi i propozuesit M.S dhe iu është caktuar kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar në lartësi prej 31.789.21 dinarë jugosllavë, me kamatë 7.5%, ndërsa në pikën II të dispozitivit ishte refuzuar propozimi i propozuesit për kompensimin e paluajtshmërisë-ndërtesën familjare, për shkak se është ndërtuar pa leje. Kjo gjykatë gjeti se nëse pjesa e refuzuar e propozimit është çështje e gjykuar, atëherë si ka mundësi që pjesa e aprovuar e propozimit të mos jetë çështje e gjykuar. Nga ana tjetër propozuesit gjatë seancës janë tërhequr nga kërkesa për kompensimin e fidaneve, ndërsa gjykata prapë ka vendosur për to. Sa i përket shpenzimeve të procedurës të vendosura si në pikën V të dispozitivit të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë fare nuk e ka vlerësuar listën e precizuar të shpenzimeve të autorizuarit të propozuesve, ndërsa e ka aprovuar vetëm shumën 1804 euro, duke mos e refuzuar dhe arsyetuar refuzimin për shumën tjetër të kërkuar të shpenzimeve sipas listës së specifikuar të shpenzimeve që gjendet në shkresat e lëndës. Andaj Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është në tërësi në kundërshtim me nenin 160.3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se edhe arsyetimi i aktvendimit të ankimuar është i mangët, kundërthënës dhe nuk ka arsye për faktet vendimtare rreth mënyrës së vendosjes nga gjykata e shkallës së parë, për faktin se arsyetimi i gjykatës lidhur me lartësinë e aprovuar të kompensimit në shumë prej 140.000 euro, është joprofesional dhe joligjor, ngase gjykata në faqen e 6 të aktvendimit të saj, e arsyeton se caktimi i çmimit nga eksperti i ndërtimtarisë në shumë prej 450.000 euro, (e që në fakt duhet të jetë 252.000 euro, sipas ekspertizës, por që gjykata gabimisht e ka shënuar këtë shumë që fare nuk përkon me vlerësimet e ekspertëve), është tejet i lartë dhe i papërbalueshëm për kompensim nga Komuna e Gjilanit dhe për këtë arsye gjykata pjesërisht e

ka refuzuar kërkesën e propozuesve për tepricën e kërkuar sipas rivlerësimit të ekspertit, ndërsa kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës, procesverbalet e seancave gjyqësore, gjeti se vetë gjykata e shkallës së parë ka kërkuar nga eksperti që ta vlerësojë paluajtshmërinë sipas çmimit aktual të tregut, ndërsa tani pa asnjë arsytim ia refuzon “tepricën” siç e cekë ajo në aktvendimin e saj. Nga ana tjetër si ka mundësi që ia refuzon 252.000 Euro, ndërsa ia aprovon 140.000 euro, ku gjykata është dashur diferencën mes shumës së kërkuar dhe asaj të aprovuar ta refuzojë e jo tërë shumën e kërkuar.

Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, për arsye se në arsyetimin e aktvendimit të saj cekë se në të vërtetë paraardhësi i paditësve nuk është kompensuar dhe se ishte neglizhuar dhe prolonguar procedura procedura për kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar lëndore nga ana e kundërpropozueses, që ky konstatim për gjykatën ankimore është i paqartë dhe hipotetik, ngase me asnjë provë nuk është vërtetuar neglizhenca apo prolongimi nga ana e kundërpropozueses, e poashtu fakti që nuk mund të gjendet aktvendimi nëse paraardhësi i propozuesve është kompensuar për pronën e eksproprijuar, në arkivin e Gjykatës Komunale, të Qarkut dhe së fundi në Gjykatën Themelore në Gjilan, DGJKP Gjilan, arkivin e Kosovës, nuk vërteton faktin se paraardhësi i propozuesve nuk është kompensuar, për arsye se nga njoftimet rezulton se nuk mund të gjendet dokumentacioni, sepse gjatë luftës së fundit në Kosovë, dokumentacioni gjendet në Serbi, andaj edhe gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të konkludojë se me të vërtetë paraardhësi i propozuesve nuk është kompensuar. Nga ana tjetër nga aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjilan N.nr. 391/1980, i dt. 23.10.1980, rezulton se është aprovuar kërkesa e paraardhësit të paditësit dhe është caktuar kompensimi për pronën lëndore të eksproprijuar edhe atë ngastra 2464-2 në sip. 0.05.60 ha , ndërsa është refuzuar kërkesa për kompensimin e shtëpisë së ndërtuar pa leje, WC fushore, murit rrethues dhe fidaneve shumëvjeçare, ku gjykata ka konstatuar se paraardhësi i propozuesve nuk ka ushtruar ankesë kundër këtij vendimi, me çka konstatohet se në heshtje pjesërisht e ka pranuar një kompensim për parcelën e eksproprijuar, ndërsa më tej vazhdon se tani kundërpropozuesja ka mbetur pranë detyrimit që propozuesve t'ia kompensojë pasurinë e paluajtshme si e ka cekur eksperti i ndërtimtarisë. Ky konstatim i gjykatës është i paqartë për arsye se nëse paraardhësi i paditësve e ka pranuar në heshtje vendimin lartcekur, nga i njëjti vendim rezulton se në atë kohë është kompensuar për parcelën e tij të eksproprijuar në dinarë të atëhershëm, atëherë shtrohet çështja se a mund të kompensohet dy herë për të njëjtën paluajtshmëri, natyrisht që jo, andaj gjykata është dashur të vlerësojë këtë fakt e më pas të vazhdojë me caktimin e ekspertizave dhe plotësimin e tyre, sepse nëse ka vlerësuar se çështja e shtëpisë, WC fushore, murit rrethues, pusit me ujë të pijshëm dhe fidaneve është çështje e gjykuar, atëherë si ka mundësi që kompensimi i caktuar për tokën i cili është vendosur me të njëjtin vendim të mos jetë çështje e gjykuar.

Poashtu Gjykata e Apelit gjeti se propozuesit kanë hequr dorë nga kërkesa për kompensimin e vlerës së fidaneve, ndërsa kjo gjykatë gjeti se fidanet janë gjykuar me aktvendimin N.nr. 508/80, të dt. 20.09.1984 të Gjykatës Komunale në Gjilan, me të cilin ishte refuzuar caktimi i kompensimit për 23 trupa pemë, ndërsa me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr.162/90, i dt. 24.05.1990, është refuzuar ankesa e paraardhësit të propozuesve dhe është vërtetuar aktvendimi N.nr. 508/80, të dt. 20.09.1984.

Nga të gjitha këto arsye Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar është dashur që të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim, pasi që nuk kishte kushte ligjore që i njëjti të ndryshohet, ashtu që në ri procedurë udhëzohet gjykata e shkallës së parë që ti eliminojë shkeljet e theksuara më lart, në mënyrë që me rastin e shqyrtimit të çështjes, fillimisht të vlerësojë faktin nëse çështja e parashtruar me propozim është çështje e gjykuar apo jo, të vërtetohet fakti nëse aktvendimi N.nr. 391/1980, i dt. 23.10.1980, është bërë i plotfuqishëm apo jo, të vërtetohet fakti se a e ka pranuar paraardhësi i propozuesve shumën e caktuar të kompensimit për pronën e ekspropriuar sipas këtij aktvendimi dhe varësisht nga të gjeturat, nëse gjykata vlerëson se çështja e parashtruar në propozim nuk është çështje e gjykuar, atëherë të caktojë seancën ku do të ftohen palët në mënyrë të rregullt, më pas të nxjerrë dhe administrojë provat relevante në drejtim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, të vërtetojë faktin nëse është kompensuar paraardhësi i propozuesve në vitet e 80 për tokën e ekspropriuar, duke vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, përfshirë edhe pretendimin e kundërpropozueses për parashkrimin e kërkesës, e më pas varësisht nga vërtetimi i këtyre fakteve, të vazhdojë me nxjerrjen e një ekspertize nga grupi i ekspertëve për vlerësimin e paluajtshmërisë, e të cilët ekspertë detyrohen të ftohen edhe në seancë nga gjykata, për të dhënë sqarime eventuale për palët ndërgjyqëse, të nxjerrë edhe prova tjera sipas nevojës, në mënyrë që të vlerësojë të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, ti administrojë të gjitha provat përkatëse relevante për vërtetimin e fakteve, si dhe të vendosë në mënyrë meritore për kërkesën për kompensimin e dëmit të propozuesit, por duke i vlerësuar drejtë edhe pretendimet e palës kundërpropozuese dhe në atë mënyrë të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, me dispozitiv të qartë dhe të përmbarueshëm, duke e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, e i cili në pikëpamje formale dhe materiale duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Pasi që aktvendimi i shkallës së parë është anuluar dhe çështja kthehet në rigjykim, priset edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, sepse në rigjykim do të krijohen edhe shpenzimet tjera lidhur me këtë çështje, andaj gjykata e shkallës së parë duhet ti vlerësojë shpenzimet e gjithmbarshme të këtij kontesti, kur vendosë për çështjen në mënyrë meritore me vendim përfundimtar, e konform nenit 465.3 të LPK-së, ashtu që do ti vlerësojë të gjitha shpenzimet e domosdoshme procedurale, duke vlerësuar edhe listën e shpenzimeve të parashtruara nga i autorizuari i propozuesve.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, në lidhje me nenin 3 të LPJK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1803//2020, datë 28.05.2024

Kryetarja e kolegjit - Gjyqtarja
Nora Billaca Dula, d.v.

Numri i lëndës: 2019:110672
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05756618